



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
*Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice*

---

Në mbështetje të nenit 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 3 pika 7, nenin 12 dhe 18 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Neni 15 i Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, nenit 17 pika 1.2 dhe 2 i Ligjit nr.05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, Akademia e Drejtësisë me 29 mars 2018 shpall këtë:

**KONKURS**

**Titulli i vendit të punës: Zyrtar/e për Personel 2**

**Numri i references: 02/20/DAF-AD**

**Koeficienti : 7**

**Pozita : Karrierës**

**Numri i vendeve të punës: 1 (një)**

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Në bashkëpunim me udhëheqësit e njërive organizative dhe zyrtarin e lartë të personelit identifikon nevojat për trajnimin e stafit të institucionit dhe rekomandon trajnime adekuate;
- Përgatit planin për trajnimin, zhvillimin dhe aftësimin personelit të ministrisë përmes trajnimeve adekuate dhe ndihmon organizimin e trajnimeve;
- Siguron që shpalljet për publikim e vendeve të lira të punës të jenë në pajtim me legjislacionin dhe standardet e përcaktuara me rregulloret përkatëse si dhe që procesi i rekrutimit të zhvillohet në pajtim me legjislacionin;
- Bashkëpunon me IKAP dhe agjencinë tjera relevante lidhur me organizimin e trajnimeve dhe evidenton në dosje të personelit të gjitha trajnimet e mbajtura;
- Ofron mbështetje profesionale për udhëheqësin dhe të gjitha komisionet e ministrisë lidhur me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil dhe menaxhimin me burimeve njerëzore;
- Siguron që të dhënat e personelit të vendosen në sistemin e informatave për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe menaxhon me SIMBNJ ;
- Përgatit dokumentacionin e nevojshëm për komisionin lidhur me procesin e rekrutimit dhe komisionet tjera të ministrisë për burimet njerëzore;
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrsi;

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim**

Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative dhe të cilët kanë aftësitë fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës mund të kryhet deri në një (1) vit para moshës së pensionimit.

Në përputhje me parimet evropiane të lëvizjes së lirë të punëtorëve dhe mos-diskriminimit, të huajt të cilët posedojnë kualifikimet e nevojshme për vendin e punës mund të pranohen në Shërbimin Civil të Kosovës. Qeveria përcakton disa funksione themelore shtetërore (që kanë të bëjnë me sovranitetin e shtetit), të cilat mund të kufizohen vetëm për shtetasit e Kosovës.

Në Shërbimin Civil të Kosovës mund të lejohet puna vullnetare-pa pagesë e nëpunësve civilë pas pensionimit, deri në moshën shtatëdhjetë (70) vjeçare. Mënyra e punës vullnetare rregullohet me Rregullore të nxjerrë nga Qeveria.

### **Procedurat e konkurrimit**

Shpallja e konkurrimit është e hapur për të gjithë të interesuarit për aplikim duke përfshirë edhe kandidatët e jashtëm.

#### **Shkollimi i kërkuar**

Diplomë Universitare, Burime Njerëzore ose Juridik E nevojshme

#### **Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen**

- Përvojë pune së paku dy (2) vite E nevojshme
- Njohuri e dhe përvojë në fushën burimeve njerëzore E nevojshme
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme lidhur shërbimin civil; E nevojshme
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit; E nevojshme
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale; E nevojshme
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion; E nevojshme
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit). E nevojshme

#### **Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin**

Procesi i rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës është i paraparë me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Bazuar në aktet ligjore të lartpërmendura kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e parapara, do t'i nënshtrohen shqyrtimit fillestar të aplikacioneve të tyre. Aplikantët më të suksesshëm do të përfshihen në listën e shkurtër dhe do të ftohen të marrin pjesë në testimin me shkrim dhe me gojë. Kandidatët që kalojnë testin me shkrim, do t'i nënshtrohen testit me gojë (intervistimit). Në fund të procesit të përzgjedhjes kandidatët e pazgjedhur kanë të drejtë në ankesë.

#### **Kohëzgjatja e emërimit:**

Emërimi është me afat te pacaktuar.

#### **Data e mbylljes së konkursit**

Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë pas shpalljes në gazetata lokale dhe në web faqen e Akademisë së Drejtësisë <https://ad.rks-gov.net>.

Data e fundit e aplikimit është 13 Prill 2018.

#### **Paraqitja e kërkesave**

Për shërbyesit civil aplikimi bëhet përmes sistemit të SIMBNJ – MAP, ndërsa për kandidatët që nuk janë shërbyes civil aplikacionet merren në web faqe të Akademisë së Drejtësisë dhe dorëzohen në zyrat e Akademia e Drejtësisë në Lagjen e Spitalit, Rr. “Muharrem Fejza” pa nr. Prishtinë, ose aplikacionin dhe dokumentet të skenuara të dërgohen në email: [burimenjerezore.ad@rks-gov.net](mailto:burimenjerezore.ad@rks-gov.net) Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për vendin e punës për të cilin konkurren. Dokumentet e pranuar nuk do të kthehen!

Kandidatët të cilën hynë në listën e ngushtë, për intervistë do të informohen me shkrim ose nëpërmjet telefonit për intervistën.

Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

**Akademia e Drejtësisë ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.**

**Komunitet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, si specifikohet në nenin 11. paragrafin 3 të Ligjit nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës .**

**Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.**

**Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.**

**Numrat kontaktues:** Për informata plotësuese, mund të kontaktoni në Akademia e Drejtësisë në numrin e telefonit: 038 200 18 528, 038 200 18 661 prej orës 08:00 – 16:00.